

Informacion mbi regjistrimin e sëmundjeve të tumorit

Fletë shpjeguese për informacione zyrtare për pacientët dhe për përfaqësuesit e tyre.

Informacione më të detajuara mund t'i gjeni në të dhënat e hollësishme të pacientëve në faqen tonë të internetit nën www.nkrs.ch, në gjuhët gjermanisht, frëngjisht, italisht dhe anglisht.



Nationale Krebsregierungsstelle
Organe national d'enregistrement du cancer
Servizio nazionale di registrazione dei tumori
National Agency for Cancer Registration



Kinderkrebsregister
Registre du cancer de l'enfant
Registro dei tumori pediatrici
Childhood Cancer Registry

Kontributi juaj për një shërbim më të mirë shëndetësor

Broshura ju informon mbi regjistrimin e përcaktuar me ligj të tumoreve beninje, pararendësve të kancerit dhe sëmundjeve të kancerit. Kjo përfshin një spektër të gjerë të rasteve. Nëse ju e merrni këtë broshurë, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se keni një tumor malinj!

Regjistrimi i sëmundjeve të kancerit mbështetet mbi ligjin federal për regjistrimin e sëmundjeve të kancerit (ligji për regjistrimin e kancerit, KRG). Sipas këtij ligji mjekët, spitalet dhe laboratorët duhet të dërgojnë informacione për sëmundjet nga tumoret në regjistrin përgjegjës të kancerit. Në këtë fletë shpjeguese ne ju informojmë për këtë, se si funksionon regjistrimi i kancerit si dhe mbi të drejtën tuaj për t'u informuar, për të parë të dhënat tuaja dhe për të kundërshtuar regjistrimin.

Informacionet për sëmundjet e tumorit grumbullohen dhe vlerësohen nga Regjistrat kantonale të kancerit [Die kantonalen Krebsregister] dhe Regjistri i kancerit për fëmijë [Kinderkrebsregister]. Të dhënat pastaj përmbliohen dhe përpunohen më tej nga Zyra kombëtare e regjistrimit të kancerit [Nationale Krebsregistrierungsstelle] dhe Regjistri i kancerit për fëmijë [Kinderkrebsregister].

Pse regjistrohen të dhënat tuaja?

Me të dhënat tuaja ju jepni një kontribut të rëndësishëm për grumbullimin e mundshëm të të gjitha rasteve të sëmundjeve. Me anë të kësaj, ju kontriboni që të përmirësohet shërbimi për të gjithë, të kuptohen sëmundjet dhe të luftohen ato.

1. E drejta juaj për informacion: Çfarë do të grumbullohet?

Regjistrat kantonalë të kancerit [Die kantonalen Krebsregister] dhe Regjistri i kancerit për fëmijë [Kinderkrebsregister] mbledhin të dhëna për personin dhe për sëmundjen. Regjistrohen llojet e mëposhtme të informacioneve:

- Informacione për personin (p.sh. mbiemri, adresa, datëlindja, numri i AHV [sigurimi i pleqërisë dhe për të pasjetuarit])
- Informacionet për sëmundjen e tumorit (p.sh. tipi dhe përhapja e tumorit, trajtimi i deritanishëm, ecuria e sëmundjes)

Në rast të tumoreve të gjirit, zorrës ose të prostatës si dhe në rast të fëmijëve dhe të të rinjve nën moshën 20 vjeç grumbullohen informacione shtesë.

Këto të dhëna plotësohen dhe aktualizohen rregullisht nëpërmjet krahasimeve me lista të jashtme (lista spitalesh, lista banorësh etj.).

UDHËZIM:

Përpara se regjistri përkatës i kancerit t'ia përcjellë të dhënat Zyrës kombëtare për regjistrimin e kancerit [Nationale Krebsregistrierungsstelle], shumica e të dhënave tuaja personale (mbiemri, adresa, data e saktë e lindjes, numri "AHV") hiqen.

2. E drejta juaj për të parë të dhënat: Ju keni akses në të dhënat personale në këtë mënyrë

Ju mund t'i shihni në çdo kohë të dhënat tuaja personale në regjistrin e kancerit.

Nëse dëshironi të shihni të dhënat tuaja, drejtojuni regjistrin të kancerit të kantonit tuaj. Për të parë të dhënat në rast të fëmijëve dhe të rinjve, kontaktoni Regjistrin e kancerit për fëmijë [Kinderkrebsregister] (www.kinderkrebsregister.ch).

3. E drejta juaj për kundërshtim

Ju mund të parashtroni me shkrim në çdo kohë një kundërshtim nëse nuk dëshironi që të dhënat tuaja të regjistrohen. Një kundërshtim vlen për gjithë jetën dhe në të gjithë Zvicrën. Po ashtu, ju mund ta tërhiqni përsëri në çdo kohë kundërshtimin.

Në rast të një kundërshtimi brenda tre muajsh pas hyrjes së njoftimit tek një regjistër i kancerit, të dhënat nuk regjistrohen por asgjësohen. Në rast të një kundërshtimi më vonë se tre muaj pas hyrjes së njoftimit tek një regjistër i kancerit do të fshihen menjëherë informacionet për personin. Informacione rreth sëmundjes qëndrojnë në regjistër.

Konstatohet se dikush ka parashtruar kundërshtim dhe, nga momenti i kundërshtimit, nuk regjistrohen më të dhëna të mëtejshme.

Kështu mund të parashtroni një kundërshtim:

1. Bëni kërkesë tek një Regjistër kantonal i kancerit [Die kantonalen Krebsregister], tek Regjistri i kancerit për fëmijë [Kinderkrebsregister] ose tek Zyra kombëtare e regjistrimit të kancerit [Nationalen Krebsregistrierungsstelle] për formularin për kundërshtim ose e shkarkoni atë në: www.nkrs.ch/downloads.
2. Plotësoni formularin dhe nënshkruajeni atë.
3. Dërgojeni formularin në një Regjistër kantonal të kancerit [Die kantonalen Krebsregister] ose në Regjistrin e kancerit për fëmijë [Kinderkrebsregister].

Ju nuk duhet ta arsyetoni kundërshtimin tuaj. Më tej ju merrni një vërtetim me shkrim nga regjistri i kancerit [Krebsregister].

Adresat e Regjistrave kantonale të kancerit [Die kantonalen Krebsregister] dhe të Regjistrit të kancerit për fëmijë [Kinderkrebsregisters] i gjeni në faqen tonë të internetit në: www.nkrs.ch/krebsregister dhe në Widerspruchsformular.

UDHËZIM:

Për kundërshtimin, ju mund të shkruani po ashtu një letër në të cilën ju jepni emrin dhe mbiemrin, adresën, datën e lindjes, numrin e të siguruarit, datën dhe nënshkrimin tuaj.

Të dhënat janë të mbrojtura në këtë mënyrë

Mbrojtja e të dhënave dhe përdorimi i të dhënave rregullohen me ligj. Regjistrat e kancerit bazohen në paracaktimet e ligjit për regjistrimin e kancerit, ligjeve dhe rregullave të tjera, të cilat janë të vlefshme në Zvicër. Përpunimi i mëtejshëm statistikor dhe përdorimi për qëllime kërkimore i nënshtrohen dispozitave të qarta.

Kështu mbrohen të dhënat tuaja:

- Në Zvicër, të dhënat qëndrojnë në sisteme elektronike të veçanta dhe të sigurta.
- Të gjithë personat, të cilët punojnë me të dhënat i nënshtrohen detyrimit për ruajtjen e fshehtësisë.
- Të gjithë mbajtësit e të dhënave kanë koncepte të veçanta për mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave.
- Persona të tjerë dhe institucione, p.sh. punëdhënësit ose arkat e sigurimit shëndetësor, nuk kanë akses në informacione.
- Informacione për publikun përgatiten gjithmonë në këtë mënyrë, në mënyrë që të mos jetë e mundur të nxirren përfundime për persona të veçantë.
- Studiuesit i marrin të dhënat vetëm nëse ekziston një miratim. Nëse nuk ekziston një miratim, ata i marrin të dhënat vetëm të bëra anonime.

Përveç kësaj duhet të asgjësohen menjëherë informacione, të cilat nuk nevojiten nga regjistri i kancerit. Pra, do të regjistrohen vetëm të dhënat, të cilat kanë një interes konkret.

Dëshironi të informoheni më saktësisht?

Zyra kombëtare për regjistrimin e kancerit [Nationale Krebsregistrierungsstelle] është referentja juaj për të gjitha pyetjet rreth regjistrimit të kancerit dhe për mbështetjen në ushtrimin e të drejtave tuaja. Regjistri i kancerit për fëmijë [Kinderkrebsregister] është referenti juaj për të gjitha pyetjet për regjistrimin e sëmundjeve të kancerit tek fëmijët dhe të rinjtë. Adresat e Regjistrave kantonale të kancerit [Die kantonalen Krebsregister] dhe të Regjistratit të kancerit për fëmijë [Kinderkrebsregister] i gjeni në faqen tonë të internetit në <https://www.nkrs.ch/krebsregister>.

Zyra kombëtare për regjistrimin e kancerit [Nationale Krebsregistrierungsstelle]

Faqja e internetit: www.nkrs.ch

E-Mail: info@nkrs.ch

Telefon: +41 44 634 53 74

Regjistri i kancerit për fëmijë [Kinderkrebsregister]

Faqja e internetit: www.kinderkrebsregister.ch

E-Mail: kinderkrebsregister@ispm.unibe.ch

Telefon: +41 31 631 48 61

Dëftues botimi

Botuesi

Zyra kombëtare për regjistrimin e kancerit [Nationale Krebsregistrierungsstelle] (NKRS)
c/o Fondacioni Instituti Kombëtar për Epidemiologjinë
dhe Regjistrimin e Kancerit [Stiftung Nationales Institut
für Krebs epidemiologie und -registrierung] (NICER)
Hirschengraben 82, 8001 Cyrih, Zvicër

Regjistri i kancerit për fëmijë [Kinderkrebsregister]
Mittelstrasse 43, 3012 Bernë, Zvicër

Koha e publikimit

Korrik 2022

Krijimi

moxi ltd., Biel

Versionet gjuhësore

Ky publikim është i disponueshëm në gjermanisht, frëngjisht, italisht, rumanisht, anglisht, shqip, arabisht, polonisht, portugalisht, rusisht, serbisht, kroatisht, spanjisht, tamilisht, turqisht, gjermanisht e thjeshtë, frëngjisht e thjeshtë dhe italisht e thjeshtë.

Një version i hollësishëm i kësaj broshure, përveç kësaj, ekziston në gjermanisht, frëngjisht, italisht dhe anglisht.

Porositja dhe shkarkimi: Publikimet në platformën e porositjes migesplus.ch mund t'i aksesoni nëpërmjet linkut të mëposhtëm → www.nkrs.ch/bestellung

Falënderime të përzemërta për punonjësit e institucioneve të mëposhtme për mbështetjen e tyre aktive në përgatitjen e informacionit për pacientët:

Zyra kombëtare për regjistrimin e kancerit [Nationale Krebsregistrierungsstelle], Regjistri i kancerit për fëmijë [Kinderkrebsregister], Regjistrat kantonalë të kancerit [Die kantonalen Krebsregister], Enti Federal për Shëndetësi BAG [Bundesamt für Gesundheit BAG], Enti Federal për Statistika BFS [Bundesamt für Statistik BFS], Konferenca e drejtorëve të shëndetësisë kantonale [Konferenz der Kantonalen Gesundheitsdirektoren] (GDK), Lidhja e mjekëve zviceranë FMH [Verbindung der Schweizer Ärztinnen und Ärzte FMH], mfe Mjekë të përgjithshëm dhe pediatër Zvicër [mfe Haus- und Kinderärzte Schweiz], H+ Spitalet në Zvicër [H+ Die Spitäler der Schweiz], Shoqata Zvicerane kundër Kancerit Oncosuisse [Schweizerische Vereinigung gegen Krebs Oncosuisse], Shoqëria Zvicerane për Menaxhimin e Cilësisë në Shëndetësi sQmh [Schweizerische Gesellschaft für Qualitätsmanagement im Gesundheitswesen sQmh], Krebsliga Zvicër [Krebsliga Schweiz], Organizata e pacientëve të fondacionit zviceran [Schweizerische Stiftung Patientenorganisation] (SPO), Shoqata koordinuese e qendrave zvicerane të pacientëve [Dachverband schweizerischer Patientenstellen]